



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 janar 2013  
Nr. ref.: RK340/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI67/12**

Parashtruesi

**Shaban Kadrija**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. I .nr. 366/2009, të 15 marsit 2012**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi**

1. Parashtrues është Shaban Kadrija, me banim në fshatin Muzeqinë, Komuna e Shtimes.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 366/2009, të 15 marsit 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pohon se është shkelur e drejta e tij për punë, e garantuar me Kushtetutë dhe me standarde ndërkombëtare.
4. Parashtruesi pret që Gjykata Kushtetuese t'ia mundësojë atij kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Ai kërkon që Gjykata të zhvleftësojë të gjitha aktgjykimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon që Gjykata Kushtetuese të urdhërojë një kompensim në të holla për humbjen e supozuar të të ardhurave, duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës të Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 12 korrik 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 27 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 6 janar 1990, Kuvendi Komunal i Shtimes, Drejtoria e të Hyrave Shoqërore, nxori Vendimin nr. 04-011-17 në bazë të të cilit parashtruesi kishte lidhur marrëdhënie të përhershme pune, me orar të plotë, në Drejtorinë e të Hyrave Shoqërore, që nga 1 janari 1990. Parashtruesi ishte caktuar në detyrën e nëpunësit për mbledhjen e taksave.
10. Më 12 tetor të të njëjtit vit, Kuvendi Komunal i Shtimes, Drejtoria e të Hyrave Shoqërore, nxori një Vendim të ri, nr. 118-21/90, me të cilin, pa pajtimin e parashtruesit, ishte ndërprerë marrëdhënia e punës së parashtruesit. Arsyeja ishte se ai kishte marrë pjesë në grevën e përgjithshme njëditore të Sindikatës së Pavarur të punonjësve të kombësisë shqiptare, të 3 shtatorit 1990, të cilën Drejtoria e konsideroi si "mungesë pa arsytim" nga vendi i punës. Për më tepër, parashtruesi nuk ka kryer punën e tij, andaj ka refuzuar obligimet e tij të punës. Kuvendi konsideroi se sjellja e tij kishte penguar punën dhe detyrat e punëtorëve të tjerë.
11. Sindikata e Pavarur e EOA, nëndegë në Shtime, nxori një deklaratë (më 18 shtator 2002), sipas kërkesës së parashtruesit, ku thuhej se Sindikata e Pavarur ka kontaktuar Organin Komunal, UNMIK-un dhe Organizatën Qendrore të Kosovës, duke u përpjekur

që ta kthejë atë (dhe punonjësit e tjerë të shkarkuar në mënyrë të ngjashme) në vendin e tyre të mëparshëm të punës.

12. Pas luftës, pasi parashtruesi nuk u kthye në vendin e tij të mëparshëm të punës, ai u përpoq të rifillojë punën në organet komunale në Shtime, duke supozuar se kjo pozitë pune i takonte atij.
13. Sidoqoftë, më 16 mars 2004, Komuna e Shtimes shpalli vendin e lirë (02. nr. 111/406) për këtë pozitë, në gazetën "Koha ditore". Parashtruesi ishte intervistuar për pozitën e lirë, por nuk ishte pranuar.
14. Del se parashtruesi kishte parashtruar dy ankesa ndaj vendimit të panelit intervistues në Komisionin Ankimor të Komunës së Shtimes (nr. 13, të parashtruar më 15 dhjetor 2003, dhe nr. 07/708, të parashtruar më 7 maj 2004). Që të dyja u refuzuan si të pabazuara, duke vendosur se procedura e shpalljes së pozitës së lirë dhe puna e Komisionit përzgjedhës ishte në përputhje me ligjin, përkatësisht me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 të KCS dhe me Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 në KCS.
15. Më 21 korrik 2004, parashtruesi parashtroi një ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili, me Vendimin A. 02/52/2004, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit, dhe mbeti në fuqi vendimi i Komisionit Ankimor, i 6 korrikut 2004.
16. Rrjedhimisht, me 26 dhjetor 2006, parashtruesi dorëzoi padinë e tij në Gjykatën Komunale në Ferizaj kundër Komunës së Shtimes, si e paditur. Ai kërkoi që Gjykata Komunale e Shtimes të anulojë vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve, sipas vendit të lirë të punës 02 nr. 111/406, të 16 marsit 2004.
17. Gjykata Komunale në Ferizaj, në Aktgjykimin e vet C. nr. 171/077, të 15 majit 2008, përcaktoi se Paneli intervistues kishte respektuar procedurat e parapara me Rregulloren e lartpërmendur të UNMIK-ut gjatë përzgjedhjes dhe refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar.
18. Gjykata e Qarkut e Prishtinës, në Aktgjykimin e vet Ac. nr. 1018/08, të 6 prillit 2009, pranoi në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë (përkatësisht të Gjykatës Komunale në Ferizaj), duke theksuar se kishte përcaktuar drejt situatën faktike, kishte zbatuar drejt të drejtën materiale, dhe se aktgjykimi nuk përmbante shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.
19. Parashtruesi dorëzoi një ankesë për revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe për zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.
20. Më 15 mars 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. I. 366/2009 dhe hodhi poshtë, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme, në arsyetimin e vet, deklaronte se "gjykata e shkallës së dytë kishte zbatuar drejt të drejtën materiale kur kishte refuzuar ankesën e parashtruesit dhe kishte konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë", arsye të cilat janë pranuar tërësisht nga kjo gjykatë.
21. Gjykata Supreme gjithashtu pohoi se "pretendimet e parashtruesit në revizionin se vendi i lirë 'nuk ishte transparent, por që vetëm aplikacionet ishin shpërndarë' nuk qëndronin, pasi që në dosje është konkursi i publikuar në gazetën "Koha ditore", për vendin e lirë të punës. Gjykata Supreme më tej theksoi se: "Komisioni intervistues i të paditurit... kishte vlerësuar kandidatët sipas dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët dhe kandidati HH ishte vlerësuar me numrin më të lartë të poenëve...".

### **Pretendimet e parashtruesit**

22. Parashtruesi pretendon se kishte pësuar padrejtësi më së shumti, pasi, sipas tij, Komisioni intervistues për pranimin në punë ishte i përbërë kryesisht nga persona me prapavijë të partive politike.
23. Parashtruesi më tej pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh një padrejtësi të tillë dhe se, sipas tij, “gjykatat nuk kanë marrë parasysh substancën dhe ligjshmërinë e problemit të tij”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

24. Siç u përmend më herët, argumenti kryesor i parashtruesit është se i është bërë padrejtësi më së shumti, pasi, sipas tij, Komisioni intervistues për pranimin në punë ishte kryesisht i përbërë nga persona me prapavijë të partive politike.
25. Gjykata Kushtetuese dëshiron të përsërisë se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I; Shih, gjithashtu, Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr. 70/11, Parashtruesit: Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A.nr. 983/08, i 7 shkurtit 2011*).
26. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren nga faktet e dorëzuara në kërkesë, se parashtruesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe që gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh dhe i janë përgjigjur me të vërtetë ankesave të tij në pikat e ligjit.
27. Prandaj, Gjykata konsideron se në kërkesë nuk ka asgjë që tregon se mungonte paanshmëria në rast, ose që procedurat ishin të padrejta (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi për papranueshmëri i GJEDNJ-së, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).
28. Në përmbyllje, parashtruesi as nuk ka ndërtuar rastin për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, as nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* për atë shkelje (*Shih, Vanek kundër Republikës Slloake, Vendimi për papranueshmëri i GJEDNJ-së, në rastin nr. 53363/99, i 31 majit 2005*).
29. Del se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36.1 (c) të Rregullores së punës që përcakton se “Gjykata vetëm mund të shqyrtojë një kërkesë nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar”.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Robert Carolan

**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani

